



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



Në bazë të nenit 38, paragrafi 2, neni 46 paragrafi 3 dhe 4, neni 104 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, Bordi i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave miraton këtë:

| | |
|---|------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVO REPUBLIC OF KOSOVO | |
| AUTORITETI RREGULLATIV I HEKURUDHAVE | |
| REGULATIVNI AUTORITETI ŽELEZNICA | |
| RAILWAY REGULATORY AUTHORITY | |
| DEP/SEK. DEP/SEK. DEP/SEK. | 01 |
| NR.PROT. BR.PROT. NR.PROT. | 832 |
| NUMRI I FAQEVE BROJ STRANA NR OF PAGES | 19 |
| DD.MM.VVVV. DD.MM.GGGG. DD.MM.YYYY. | 22/12/2017 |
| PRISHTINË / A | |

Rregullore Nr. 04/2017, për Metodat e Përbashkëta të Sigurisë për Vlerësimin e Konformitetit me kërkesat për marrjen e Autorizimit të Sigurisë hekurudhore

Rr. Rustem Statovci nr.29
Prishtinë, Kosovë
Tel:+381 38 22 00 40
Fax:+381 38 22 33 40
Web:www.arh-ks.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

Neni 1 **Qëllimi**

1. Kjo Rregullore përcakton një metodë të përbashkët të sigurisë (MPS) për vlerësimin e konformitetit me kërkesat për marrjen e autorizimit të sigurisë, siç përshkruhet në nenin 46 (3 dhe 4), nenin 104 (2) të Ligjit 04/L-063 për hekurudhat në Republikën e Kosovës si dhe nenin 6 (3) (b) dhe nenin 11 të Direktivës 2004/49 / EC. Kjo rregullore amandamenton Rregulloren e ARH-së me Nr. 03/2012, si dhe transponon rregulloren e BE-së me Nr. 1169/2010/EU.

MPS përfshinë:

1.1. procedurën dhe kriteret për vlerësimin e aplikacioneve të bëra nga menaxherët e infrastrukturës për marrjen e autorizimit të sigurisë, siç përmendet në Ligjin Nr. 04/L-063 neni 46 dhe 104, si dhe në nenin 11 (1) (a) dhe (b) të Direktivës 2004/49 / EC, siç përcaktohet në Shtojcën I dhe II të kësaj rregullore.

1.2. parimet për mbikëqyrjen e përputhjes me kërkesat e Direktivës 2004/49 / EC pasi që organi nacional i sigurisë ka dhënë autorizimin, siç përcaktohet në Shtojcën III të kësaj rregullore.

1.3. autorizimi i sigurisë autorizon operimin në infrastrukturën hekurudhore të përdorimit të përbashkët në Kosovë, vetëm nëse paraprakisht është dhënë licenca përkatëse.

Neni 2 **Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen për të gjithë menaxherët e infrastrukturës hekurudhore të cilët operojnë ligjërisht brenda territorit të Republikë së Kosovës.

Neni 3 **Definicionet**

Për qëllimet e kësaj Rregullore, do të zbatohet përkufizimi i mëposhtëm:

"mbikëqyrja" nënkupton masat e aplikuara nga organi i sigurisë për të mbikëqyrur performancën e sigurisë, pasi që ky organ të ketë dhënë një autorizim të sigurisë.

Neni 4 **Formulari i aplikimi për autorizim të sigurisë**

Për të aplikuar për autorizim të sigurisë, aplikanti duhet të përdor formularin e aplikimit të ofruar nga ARH, ky formular mund të gjendet në faqen tonë të internetit www.arh-ks.org.

